

Riciklimi dhe standardi i mbetjeve në Lezhë

Zgjerimi i ndarjes në burim dhe sistemit të diferencuar të grumbullimit të mbetjeve në Lezhë.

Konteksti

Strategjia dhe Plani Kombëtar për Menaxhim të Integruar parashikon për të gjitha njësitë e qeverisjes vendore ngritjen e një sistemi të mbledhjes së ndarë të mbetjeve urbane, deri në vitin 2015.

Objektivi

Objektivi kryesor i projektit është zgjerimi i mbledhjes së ndarë të mbetjeve që kryhet deri më tani në qytetin e Lezhës.

Nëpërmjet mbledhjes së ndarë të mbetjeve urbane, sasia prej tyre që depozitohet në landfill-in Bushat do të jetë më e ulët, dhe për rrjedhojë edhe kostot e transportit dhe trajtimit në landfill do të ulen, në përfitim të njësisë vendore dhe banorëve të qytetit të Lezhës.

Aktivitetet

Projekti përmban këto aktivitete:

- Organizimi i mbledhjes derë më derë të mbetjeve në zonat rurale të Bashkisë Lezhë. *Për mbledhjen e mbetjeve të riciklueshme do të përdoren qese ngjyrë blu.*
- Ndërgjegjësimi i popullsisë së zonës së përzgjedhur në qytetin e Lezhës për zbatimin e projektit, mbi kërkesat e mbledhjes së mbetjeve



të riciklueshme në burim.

- Mbështetja e Bashkisë Lezhë në formalizimin e Qendrës së Mbetjeve të Riciklueshme që vepron prej vitit 2012, si dhe ngritjen e një menaxhimi të qëndrueshëm të saj.

Projekti përfshin dhe përlogaritjen e kostos dhe tarifës së dhënies së shërbimit të grumbullimit të mbetjeve, sipas metodologjisë së hartuar nga DLDP.

Përfshirja shoqërore

Zbatimi i këtij projekti kryhet përmes *aktivizimit të komuniteteve të marxhinalizuara të shoqërisë me qëllim përfshirjen shoqërore të tyre: në këtë drejtim, komuniteti roma, i cili punon në sektorin jo formal, merr pjesë në organizimin e një skeme të menaxhimit të integruar të mbetjeve të qytetit të Lezhës.*

FAKTET KRYESORE

PARTNERË

- Helvetas Swiss Intercooperation
- Programi për Decentralizim dhe Zhvillim Vendor DLDP

KOHËZGJATJA

Korrik 2014 – Qershor 2015

BASHKËPUNËTORË

- Bashkia Lezhë

KONTAKT:

Zana Vokopola
Drejtoreshë Ekzekutive

Instituti i Kërkimeve Urbane

Rr. Asim Vokshi, Nd.14
Hyrja 11, Ap. 56
Tiranë

Tel: +355 4 2256840

E-mail: zvokopola@uri.org.al

Web: www.uri.org.a

Rreth IKU

Që nga viti 1999 Instituti i Kërkimeve Urbane (IKU) ka dhënë rezultate të mëdha për projektet dhe programet e zhvillimit të realizuara në të gjithë Shqipërinë. Puna jonë ynë kryesore përqendrohet në zhvillimin e komunitetit, forcimin e qeverisjes vendore, mbrojtjen e mjedisit, decentralizimin dhe shërbimet publike. Ne kryejmë studime, llojshmëri qeverinë, trajnojmë njësitë e qeverisjes vendore, rrisim aksesin e publikut në informacion, dhe lidhim partnerët në punën për zhvillim.. IKU ka punuar me donatorë si USAID, Bashkëpunimi Zviceran, Ambasada Holandeze, UNDP, Banka Botërore, BE, SIDA, Shoqëri të Hapur / Fondacioni Soros, etj.